

BASHKIA TIRANË
AGJENCIA E SHËRBIMEVE FUNERALE
NJËSIA E PROKURIMIT

Data: 17. 03. 2025

PROCESVERBAL - Tipi i kontratës - Mallra

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

Objekti i Procedurës: “Blerje elemente te parapergatitur hekur-beton (dy lote): Loti 1 Blerje borduar provizore varri. Loti 2 Blerje veshje nentoksore varri”.

“Loti 1: Blerje bordura provizore varri”

“Loti 2: Blerje veshje nentokësore varri”

Kodi përkatës në fjalorin e përbashkët të prokurimit (FPP): Pllaka betoni 44114250-9.

VLERA E FONDIT LIMIT: - Vlera e përlllogaritur e fondi limit: Blerje elemente të parapërgatitura hekur – betoni (2 lote): **28,517,458.23** (njëzet e tetë milion e pesëqind e shtatëmbëdhjetë mijë e katërqind e pesëdhjetë e tetë pikë njëzet e tre) lekë pa TVSH ose **286,032.68** (dyqind e tetëdhjetë e gjashtë mijë e tridhjetë e dy euro e gjashtëdhjetë e tetë cent) konvertuar me kursin e Bankës së Shqiperisë më datë 17.03.2025, ora 13:13. Vënë në dispozicion nga Buxheti i Bashkisë Tiranë.

- Vlera e përlllogaritur e fondit limit për objektin: “Loti 1: Blerje bordura provizore varri”, me fond limit: **7, 340, 791. 23** (shtatë milion e treqind e dyzet mijë e shtatëqind e nëntëdhjetë e një pikë njëzet e tre) lekë pa TVSH ose **73,628.80** (shtatëdhjetë e tre mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë e tetë euro e tetëdhjetë cent) konvertuar me kursin e Bankës së Shqiperisë më datë 17.03.2025, ora 13:13. Vënë në dispozicion nga Buxheti i Bashkisë Tiranë.

- Vlera e përlllogaritur e fondit limit për objektin: “Loti 2: Blerje veshje nentokësore varri”, me fond limit: **21,176,667.00** (njëzet e një milion e njëqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH ose **212,403.88** (dyqind e dymbëdhjetë mijë e katërqind e tre euro e tetëdhjetë e tetë cent) konvertuar me kursin e Bankës së Shqiperisë më datë 17.03.2025, ora 13:13. Vënë në dispozicion nga Buxheti i Bashkisë Tiranë.

Njësia e Prokurimit për procedurën në fjalë vendos që lloji i procedurës së prokurimit të jetë:

Procedurë e Hapur, mallra.

Arsyet e përdorimit të procedurës - “E hapur”, është pasi vlera e fondit limit është ndërmjet kufirit të ulët dhe të lartë monetar.

Kriteret e përgjithshme të pranimi janë standarte dhe nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe nenit 2 pika “c”, nenit 78 pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor, Agjencia e Shërbimeve Funerale, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT
OFERTUESI DEKLARON SE:**

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.
- j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, **sipas Shtojcës 9.**

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/Enti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet:

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

Në zbatim të nenit 76 të LPP, i ndryshuar, kriteret detyruese për skualifikim janë të parashikuar në shtojcën 8 “*Formulari i kriterëve të përzgjedhjes së ofertuesve*” dhe ato nuk mund të ndryshohen nga autoriteti kontraktor.

Fondi limit: - Vlera e përlllogaritur e fondi limit: Blerje elemente të parapërgatitura hekur – betoni (2 lote): **28,517,458.23** (njëzet e tetë milion e pesëqind e shtatëmbëdhjetë mijë e katërqind e pesëdhjetë e tetë pikë njëzet e tre) lekë pa TVSH.

- Vlera e përlllogaritur e fondit limit për objektin: “Loti 1: Blerje bordura provizore varri”, me fond limit: **7, 340, 791. 23** (shtatë milion e treqind e dyzet mijë e shtatëqind e nëntëdhjetë e një pikë njëzet e tre) lekë pa TVSH.

- Vlera e përlllogaritur e fondit limit për objektin: “Loti 2: Blerje veshje nëntokësore varri”, me fond limit: **21,176,667.00** (njëzet e një milion e njëqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH.

LOTI 1: BLERJE BORDURA PROVIZORE VARRI

Fondi limit: - Vlera e përlogaritur e fondi limit: Blerje elemente të parapërgatitura hekur – betoni (2 lote): **28,517,458.23** (njëzet e tetë milion e pesëqind e shtatëmbëdhjetë mijë e katërqind e pesëdhjetë e tetë pikë njëzet e tre) lekë pa TVSH.

- Vlera e përlogaritur e fondit limit për objektin: “Loti 1: Blerje bordura provizore varri”, me fond limit: **7, 340, 791. 23** (shtatë milion e treqind e dyzet mijë e shtatëqind e nëntëdhjetë e një pikë njëzet e tre) lekë pa TVSH.

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kriteret duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 26 të VKM-se nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2021, 2022, 2023), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **në një vlerë jo më të vogël se 40% e fondit limit të përlogaritur**. Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare”.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe në nenin 43 pika 2 dhe neni 55 pika 4 e VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2, të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar ku përcaktohet se: “*Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata*”. Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, në lidhje me situatën ekonomike dhe

financiare të OE ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për të zbatuar me sukses kontratën siç është parashikuar nga AK.

Për sa i takon përcaktimit të vlerës së kërkuar **në një vlerë jo më të vogël se 40% e fondit limit të përlllogaritur**, është brenda kufirit të përcaktuar në nenin 43 pika 2 dhe neni 55 pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku parashikohet se *“Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:*

a) *dyfishin e vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar”.*

b) *vlerën e përlllogaritur të kontratës ose lotit , në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar;*

c) **40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në kontratat e shërbimit me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posacme.**

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të certifikuara të bilanceve të viteve: **(2021, 2022, 2023)** të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me *raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese.*

Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse në dy bilancet e njëpasnjëshme të kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar; nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku përcaktohet se: *“Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Nëse kërkohen një ose dy bilance, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancin/et e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit”, Nëse kërkohen bilance të tre viteve të fundit, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilancet e njëpasnjëshme të kërkuara, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit si dhe në pikën 5 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “Tatimpaguesit që mbajnë kontabilitet sipas kërkesave të ligjit përkatës, paraqesin deklaratën vjetore së bashku me pasqyrat financiare, si dhe të dhëna të tjera të përcaktuara në udhëzimin e ministrit përgjegjës për financat për zbatimin e këtij ligji.”, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” të ndryshuar. Si dhe bazuar në Ligjin nr.10091, date 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar, Kreu V, neni 41, pika c.*

Me anë të këtij kriteri, për paraqitjen e bilanceve, është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorit ekonomik, të cilët duhet të vërtetojnë se zotërojnë

kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.2.3 Vetëdeklarim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2024, sipas Ligjit 9632, datë 30.10.2006 "Per sistemin e taksave vendore", i ndryshuar, nëpërmjet paraqitjes së formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë se ka paguar detyrimet e taksave vendore për vitin 2024, të parashikuara në ligjin 9632, datë 30.10.2006 në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të DST-së objekt prokurimi.

Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 9 në DST, dokumentet përkatëse vërtetuese do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Argumentimi: Kërkesa e mesepërme është percaktuar bazuar në nenin 77 pika 3 e LPP, i ndryshuar, si dhe nenit 43 pika 6, nenit 40 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Per miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, dhe në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 "Per Sistemin e Taksave Vendore", i ndryshuar në ligjin nr. 9920 datë 19.05.2008 "Per procedurat tatimore", i ndryshuar, nën 40, në ligjin nr. 131/2015 "Per QKB", i ndryshuar.

Per të vërtetuar që subjekti nuk është debitor në pagimin e taksave vendore të Qeverisjes Vendore dhe është subjekt që garanton qëndrueshmëri dhe është korrekt me detyrimet ligjore që ai ka. Është kërkuar vetëm viti 2024 për të siguruar konkurrencë të lirë për gjithë OE fizike apo juridike.

Ky kriter shërben për të garantuar AK se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, kanë kapacitetet e duhura ekonomike dhe financiare si dhe janë të përshtatshëm për të kryer veprimtari profesionale. Referuar sa më sipër, Autoriteti Kontraktor gjykon se kriteri i vendosur lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të deklaratës për shlyerjen e detyrimeve vendore për vitin 2024, pranë bashkisë/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 për "Sistemin e Taksave Vendore" i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari Biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për t'iu nënshtuar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

Në çdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

2.2 Kapaciteti teknik:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20% e fondit limit të **lotit 2/shumatores së loteve për të cilat konkurron** (Shumatores së fondit limit të loteve nëse kontrata është e ndarë në lote dhe ofertohet për më shumë se një lot, **sipas përqindjeve respektive të secilit lot**).

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

-Operatorët ekonomikë si dëshmi për përvojën e mëparshme duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

-Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar me Ligjin nr. 16/2024, datë 8.2.2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 55, pika 4/b, neni 42, pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20% të vlerës së fondit limit të **lotit 2/shumatores së loteve për të cilat konkurron** (Shumatores së fondit limit të loteve nëse kontrata është e ndarë në lote dhe ofertohet për më shumë se një lot, **sipas përqindjeve respektive të secilit lot**) që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Vlera e kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj. Vlera e kërkuar është vendosur që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme si dhe përvojën e duhur, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.Operatorët ekonomik pjesëmarrës, duhet të disponojë **të paktën 1(një) një mjet transporti** (kamion) për transportin e mallrave objekt i kontratës, të cilin duhet ta ketë në pronësi/qira/huapërdorje.

- a) Për mjetet në pronësi duhet të paraqitet: a) dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (akti i pronësisë); leje qarkullimi; çertifikatë për transport mallrash (e vlefshme), çertifikatë e kontrollit teknik, (i vlefshëm); siguracion mjeti, (i vlefshëm).
- b) Për mjetet e deklaruar me qera/huapërdorje duhet të paraqitet: kontrata përkatëse noteriale e qerasë/huapërdorjes e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi dokumenti që vërteton regjistrimin e tij (akti i pronësisë), leje qarkullimi; çertifikatë e kontrollit teknik, (i vlefshëm).; çertifikatë për transport mallrash, (i vlefshëm), siguracion mjeti (i vlefshëm);

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë mjetin që disponon në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit. Në zbatim të nenit 26 pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar me Ligjit nr. 16/2024, datë 8.2.2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Ligjin Nr. 8308, datë 18/03/1998 “Për transportet rrugore” (i ndryshuar), Vendimit Nr.325, datë 19.03.2008 “Për miratimin e rregullave për pranimin në veprimtarinë e operatorit të transportit rrugor të mallrave dhe të udhëtarëve, si dhe për njohjen e dokumenteve zyrtarë, të caktuara për këto operator”; Udhëzimin Nr.15, datë 24/07/2007 “Për kriteret dhe procedurat e lëshimit të licencave, autorizimeve dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor” (i ndryshuar), me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjete dhe pajisje teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Ky kriter është minimal në përpjesëtim dhe i lidhur ngushtësisht me natyrën dhe përmasat e kontratës, duke marrë në konsideratë faktin se malli objekt kontrate do të transportohet nga furnizuesi në ambientet sipas kërkesës së autoritetit kontraktor.

3.Operatorët ekonomikë pjesëmarrës për realizimin e objekt prokurimi, duhet të ketë minimalisht të punësuar 5 vetë, përkatësisht 1 (një) shofer dhe 4 (katër) punëtor ngarkim shkarkimi. Për këtë kriter operatorët ekonomikë duhet të dorëzojë dokumentacionin si më poshtë:

- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet Shoqërore ose Administrata Tatimore sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj, për periudhën Janar-Shkurt 2025.
- Listë pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën Janar- Shkurt 2025.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë stafin që disponon në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit. Në zbatim të nenit 26 pika 6 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin.

Shënim: Në rastin e marrjes së kamionit me qera/huapërdorje, OE duhet të ketë minimalisht të punësuar 4 vetë. Të 4 (katër) të jenë punëtor ngarkim shkarkimi, kurse shoferi duhet të paraqesë kontratën e punës dhe nuk kërkohet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar me Ligjit nr. 16/2024, datë 8.2.2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion fuqi punëtore për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Arsyeja e përcaktimit të numrit të punëtorëve: Për vendosjen e këtij kriteri përveç sasisë dhe grafikut të lëvrimit janë marrë në konsideratë edhe vendi ku do të kryhet furnizimi dhe procesi i ngarkim shkarkimit të mallrave. Nje komplet bordure provizore varri ka 5 elemente betonarme. Duke qene elemente betonarme, ato kane nje peshe e gjatësi te konsiderueshme dhe procesi i ngarkim- shkarkimit per nje rruge kerkon minimalisht 4 punonjes (dy lart ne makine dhe dy poshte ne terren).

Vetëm përdorimi i një mjeti, e cila është domosdoshmëri për transportin e bordurave provizore të varrit do të kërkonte një personel prej 5 vetash 1 shofer dhe 4 punëtorë transporti. Kjo është praktika e ndjekur deri tani në terren nga firmat furnizuese në kontrata të mëparshme.

4. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin deklaratë që furnizimi do të bëhet me mjetet dhe shpenzimet e operatorit ekonomik fitues, sipas grafikut të lëvrimit të përcaktuar nga autoritetit kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar me Ligjit nr. 16/2024, datë 8.2.2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që marrin përsipër

realizimin e objektit të kontratës, nëpërmjet transportit me mjetet dhe shpenzimet e tyre, sipas grafikut të lëvrimit të vendosur nga autoriteti kontraktor.

5. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin certifikatë të vlefshme të cilësisë, ku të përfshijë objektin që prokurohet, të cilat duhet të jenë të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të noterizuara, sipas standardeve:

- **Çertifikatë ISO 9001:2015 ose ekuivalente/të barazvlefshme – Standart për “Sistemin e menaxhimit të cilësisë”**

Certifikata të jetë lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar me Ligjit nr. 16/2024, datë 8.2.2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 44, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, këto certifikata lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës për sa kohë do të pronohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës. Referuar në nenin 79 të ligjit 162/2020, i ndryshuar me Ligjit nr. 16/2024, datë 8.2.2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” parashikohet se autoriteti kontraktor mund të kërkojë certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë.

(Shënim: Autoriteti/enti kontraktor, në varësi të natyrës së objektit të prokurimit, mund të përcaktojë kritere të tjera të vecanta, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës, duke argumentuar teknikisht dhe ligjërisht çdo kriter, duke përcaktuar, sipas rastit, aktin ligjor/nënligjor që parashikon domosdoshmërinë e kriterit në fjalë).

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

LOTI 1. BORDURA PROVIZORE VARRI

SPECIFIKIME TEKNIKE

1. Një komplet bordura për të rritur me beton përbëhet nga:

- 2 cope pllaka (anësore) me permasa 30(10)x180x4cm dhe hekur;
- 1 cope pllakë (ballore) me permasa 20x80x4cm dhe hekur;
- 1 cope pllakë (fundore) me permasa 10x80x4cm dhe hekur;
- 1 cope pllakë (kapak) me permasa 20x80x4cm dhe hekur;

Betoni i përdorur të jetë M-200 ose C16/20 dhe hekur $\varnothing 6$ mm. Armatura e hekurit është çelik S-500 dhe $400\text{N/mm}^2 \leq F_{yk} \leq 600\text{N/mm}^2$ (rezistenca në rrjedhje), e parashikuar në projekt. Armimi jepet në projektin bashkëlidhur. Elementët duhet të kalojnë periudhën e stazhionimit dhe të shoqërohen me fletë analiza (raporte për betonin dhe hekurin) në kohën e furnizimit.

2. Një komplet bordura për të rritur përbëhet nga:

- 2 cope pllaka (anësore) me permasa 15 (10)x70x4cm dhe hekur;
- 1 cope pllakë (ballore) me permasa 20x40x4cm dhe hekur;
- 1 cope pllakë (fundore) me permasa 10x40x4cm dhe hekur;
- 1 cope pllakë (kapak) me permasa 15x40x4cm dhe hekur;

Betoni i përdorur të jetë M-200 ose C16/20 dhe hekur $\varnothing 6$ mm. Armatura e hekurit është çelik S-500 dhe $400\text{N/mm}^2 \leq F_{yk} \leq 600\text{N/mm}^2$ (rezistenca në rrjedhje), e parashikuar në projekt. Armimi jepet në projektin bashkëlidhur. Elementët duhet të kalojnë periudhën e stazhionimit dhe të shoqërohen me fletë analiza (raporte për betonin dhe hekurin) në kohën e furnizimit.

Skicimet për bordure provizore varri do të jenë bashkëlidhur DST

Argumentimi i specifikimeve teknike: Specifikimet teknike për mallrat objekt prokurimi të secilit lot, janë hartuar nga specialisti i fushës, anëtar i njësisë së prokurimit, të cilat janë bashkëlidhur me dokumentet standarte të tenderit. Ato përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, i ndryshuar me Ligjit nr. 16/2024, datë 8.2.2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP, i ndryshuar me Ligjit nr. 16/2024, datë 8.2.2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Grafiku i lëvrimit hartuar nga specialisti i fushës, është si më poshtë vijon:

LOTI 1: BLERJE BORDURA PROVIZORE VARRI

Sasia e mallit që kërkohet:

Artikulli	Përshkrimi	Njësia	Sasia	Destinacioni	Periudha e dorëzimit
1	Bordura varri për të rritur	Komplete	2500	Varrezat Sharrë Tufinë Magazinë	Sipas grafikut të lëvrimit
2	Bordura varri për të mitur	Komplete	131	Varrezat Sharrë Tufinë Magazinë	Sipas grafikut të lëvrimit

Grafiku i lëvrimit të mallit

Nr.	Përshkrimi i mallit	Njësia	Sasia	Muajt							
				Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
1	Bordura varri për të rritur	Komplete	2500	0	0	200	300	300	400	400	900
2	Bordura varri për të mitur	Komplete	131	31	10	10	10	10	15	15	30

Afatet e lëvrimit: Afati i lëvrimit fillon nga data e nënshkrimit të kontratës dhe përfundon më 31.12.2025

Argumentimi i grafikut: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenet 15, ika 3/b si dhe nenit 40, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Grafiku i lëvrimit për mallrat objekt prokurimi është hartuar nga specialisti i fushës, anëtar i njësisë së prokurimit. Grafiku është bashkëlidhur dokumentave të tenderit dhe është hartuar në përputhje me nevojat e sektorëve. Në muajt e fundit të vitit kërkohen më shumë, në mënyrë që të krijohet rezerva për muajt e parë të vitit pasardhës.

Shënim: Operatorët ekonomikë ofertues në më shumë se një Lot, duhet të kenë kapacitetet teknike (nënpika 1 e pikës 2.2, të kriterëve të veçanta për kualifikim), sa shuma e loteve për të cilat ka ofertuar, të marra së bashku. Në rast se dokumentacioni i deklaruar dhe i dorëzuar në përmbushje të kriterëve kumulative nuk plotëson kapacitetet ekonomike - financiare dhe kapacitetet teknike për të gjitha Lotet ku operatori ekonomik ka ofertuar, do të skualifikohet nga të gjitha Lotet ku ka ofertuar.

Shënim: Në mbështetje të nenit 88 pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, nëse kemi bashkim operatorësh ekonomikë, secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, i ndryshuar me Ligjit nr. 16/2024, datë 8.2.2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

LOTI 2: BLERJE VESHJE NËNTOKËSORE VARRI

- Vlera e përlogaritur e fondi limit: Blerje elemente të parapërgatitura hekur – betoni (2 lote): **28,517,458.23** (njëzet e tetë milion e pesëqind e shtatëmbëdhjetë mijë e katërqind e pesëdhjetë e tetë pikë njëzet e tre) lekë pa TVSH.

- Vlera e përlogaritur e fondit limit për objektin Loti 1: Blerje veshje nëntokësore varri me fond limit **21, 176, 667. 00** (njëzet e një milion e njëqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH.

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kriteret duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 26 të VKM-se nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2021, 2022, 2023), vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **në një vlerë sa vlera e perlllogaritur e kontrates, sa vlera e fondit limit te perlllogaritur.** Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe në nenin 43 pika 2 e VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare të OE ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për të zbatuar me sukses kontratën siç është parashikuar nga AK.

Për sa i takon përcaktimit të vlerës së kërkuar **në një vlerë sa vlera e perlllogaritur e kontrates, sa vlera e fondit limit te perlllogaritur** është brenda kufirit të përcaktuar në nenin 43 pika 2 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku parashikohet se “*Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:*

a) *dyfishin e vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar*”.

b) vlerën e përlllogaritur të kontratës ose lotit , në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar;

c) 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në kontratat e shërbimit me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posacme.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të certifikuara të bilanceve të viteve: (2021, 2022, 2023) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me *raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese.*

Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse në dy bilancet e njëpasnjëshme të kërkuara nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar; nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku përcaktohet se: “*Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin*

informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Nëse kërkohen një ose dy bilance, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancin/et e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit”, **Nëse kërkohen bilance të tre viteve të fundit, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilancet e njëpasnjëshme të kërkuara, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit** si dhe në pikën 5 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “Tatimpaguesit që mbajnë kontabilitetin sipas kërkesave të ligjit përkatës, paraqesin deklaratën vjetore së bashku me pasqyrat financiare, si dhe të dhëna të tjera të përcaktuara në udhëzimin e ministrit përgjegjës për financat për zbatimin e këtij ligji.”, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” të ndryshuar. Si dhe bazuar në Ligjin nr.10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar, Kreu V, neni 41, pika c.

Me anë të këtij kriteri, për paraqitjen e bilanceve, është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorit ekonomik, të cilët duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.2.3 Vetëdeklarim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2024, sipas Ligjit 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar, nëpërmjet paraqitjes së formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë se ka paguar detyrimet e taksave vendore për vitin 2024, të parashikuara në ligjin 9632, datë 30.10.2006 në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të DST-së objekt prokurimi.

Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotesimin e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 9 në DST, dokumentet përkatëse vërtetuese do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Argumentimi: Kërkesa e mesepërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 3 e LPP, i ndryshuar, si dhe nenit 43 pika 6, nenit 40 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, dhe në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar në ligjin nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore”, i ndryshuar, neni 40, në ligjin nr.131/2015 “Për QKB”, i ndryshuar.

Për të vërtetuar që subjekti nuk është debitor në pagimin e taksave vendore të Qeverisjes Vendore dhe është subjekt që garanton qëndrueshmëri dhe është korrekt me detyrimet ligjore që ai ka. Është kërkuar vetëm viti 2024 për të siguruar konkurrencë të lirë për gjithë OE fizike apo juridike.

Ky kriter shërben për të garantuar AK se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, kanë kapacitetet e duhura ekonomike dhe financiare si dhe janë të përshtatshëm për të kryer veprimtari profesionale. Referuar sa më sipër, Autoriteti Kontraktor gjykon se kriteri i vendosur lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të deklaratës për shlyerjen e detyrimeve vendore për vitin 2024, pranë bashkisë/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari Biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për t’iu nënshtuar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

Në çdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

2.2 Kapaciteti teknik:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme të ngjashme, të realizuar gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të madhe se 40% e fondit limit të **lotit 2/ shumatores së loteve për të cilat konkuron.** (Shumatores së fondit limit të loteve nëse kontrata është e ndarë në lote dhe ofertohet për më shumë se një lot, **sipas përqindjeve respektive të secilit lot**).

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- Operatorët ekonomikë si dëshmi për përvojën e mëparshme duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar me Ligjin nr. 16/2024, datë 8.2.2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, dhe nenit 40, pika 4, neni 42 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më të madhe se 40% e fondit limit të **lotit 2/ shumatores së**

loteve për të cilat konkurron. (Shumatores së fondit limit të loteve nëse kontrata është e ndarë në lote dhe ofertohet për më shumë se një lot, **sipas përqindjeve respektive të secilit lot**), e cila është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Vlera e kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj. Vlera e kërkuar është vendosur që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme si dhe përvojën e duhur, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.Operatorët ekonomik pjesëmarrës, duhet të disponojë **të paktën 1(një) një mjet transporti** (kamion) për transportin e mallrave objekt i kontratës, të cilin duhet ta ketë në pronësi/qira/huapërdorje.

c) Për mjetet në pronësi duhet të paraqitet: a) dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (akti i pronësisë); leje qarkullimi; çertifikatë për transport mallrash (e vlefshme), çertifikatë e kontrollit teknik, (i vlefshëm); siguracion mjeti, (i vlefshëm).

d) Për mjetet e deklaruara me qera/huapërdorje duhet të paraqitet: kontrata përkatëse noteriale e qerasë/huapërdorjes e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi dokumenti që vërteton regjistrimin e tij (akti i pronësisë), leje qarkullimi; çertifikatë e kontrollit teknik, (i vlefshëm); çertifikatë për transport mallrash, (i vlefshëm), siguracion mjeti (i vlefshëm);

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë mjetin që disponon në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit. Në zbatim të nenit 26 pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar me Ligjit nr. 16/2024, datë 8.2.2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, Ligjin Nr. 8308, datë 18/03/1998 “Për transportet rrugore” (i ndryshuar), Vendimit Nr.325, datë 19.03.2008 “Për miratimin e rregullave për pranimin në veprimtarinë e operatorit të transportit rrugor të mallrave dhe të udhëtarëve, si dhe për njohjen e dokumenteve zyrtarë, të caktuara për këto operator”; Udhëzimin Nr.15, datë 24/07/2007 “Për kriteret dhe procedurat e lëshimit të licencave, autorizimeve dhe çertifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor” (i ndryshuar), me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në

dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion mjete dhe pajisje teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Ky kriter është minimal në përpjesëtim dhe i lidhur ngushtësisht me natyrën dhe përmasat e kontratës, duke marrë në konsideratë faktin se malli objekt kontrate do të transportohet nga furnizuesi në ambientet sipas kërkesës së autoritetit kontraktor.

3.Operatorët ekonomikë pjesëmarrës për realizimin e objekt prokurimi, duhet të ketë minimalisht **të punësuar 5 vetë, përkatësisht 1 (një) shofer dhe 4 (katër) punëtor** ngarkim shkarkimi. Për këtë kriter operatorët ekonomikë duhet të dorëzojë dokumentacionin si më poshtë:

- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet Shoqërore ose Administrata Tatimore sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj, për periudhën Janar-Shkurt 2025.

- Listë pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën Janar-Shkurt 2025.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë stafin që disponon në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit. Në zbatim të nenit 26 pika 6 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin.

Shënim: Në rastin e marrjes së kamionit me qera/huapërdorje, OE duhet të ketë minimalisht të punësuar 4 vetë. Të 4 (katër) të jenë punëtor ngarkim shkarkimi, kurse shoferi duhet të paraqesë kontratën e punës dhe nuk kërkohet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar me Ligjit nr. 16/2024, datë 8.2.2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, dhe nenit 40, pika 5/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion fuqi punëtore për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Arsyeja e përcaktimit të numrit të punëtorëve: Për vendosjen e këtij kriteri përveç sasisë dhe grafikut të lëvrimit janë marrë në konsideratë edhe vendi ku do të kryhet furnizimi dhe procesi i ngarkim shkarkimit të mallrave. Një komplet veshje nëntokësore varri për të mitur deri në moshën 10 vjec ka 6 elemente betonarme dhe një komplet veshje nëntokësore varri për të rritur mbi 10 vjeç ka 10 elemente betonarme. Duke qënë elemente betonarme, ato kanë një peshë të konsiderueshme dhe procesi i ngarkim- shkarkimit për një element të kompletit kërkon minimalisht 4 punonjës (dy lart në makinë dhe dy poshtë në terren).

Vetëm përdorimi i një mjeti, i cili është domosdoshmëri për transportin e veshjeve nëntokësore të varrit do të kërkonte një personel prej 5 vetash: 1 shofer dhe 4 punëtorë transporti. Kjo është praktika e ndjekur deri tani në terren nga firmat furnizuese në kontrata të mëparshme.

4. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin deklaratë që furnizimi do të bëhet me mjetet dhe shpenzimet e operatorit ekonomik fitues sipas grafikut të lëvrimit të përcaktuar nga autoritetit kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar me Ligjit nr. 16/2024, datë 8.2.2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, dhe nenit 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që marrin përsipër realizimin e objektit të kontratës, nëpërmjet transportit me mjetet dhe shpenzimet e tyre, sipas grafikut të lëvrimit të vendosur nga autoriteti kontraktor.

5. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin certifikatë të vlefshme të cilësisë, ku të përfshijë objektin që prokurohet, të cilat duhet të jenë të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të noterizuara, sipas standardeve:

- **Certifikatë ISO 9001:2015 ose ekuivalente/të barazvlefshme – Standart për “Sistemin e menaxhimit të cilësisë”**

Certifikata të jetë lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar me Ligjit nr. 16/2024, datë 8.2.2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, dhe nenit 44, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, këto certifikata lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës përsa kohë do të pronohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës. Referuar në nenin 79 të ligjit 162/2020, i ndryshuar me Ligjit nr. 16/2024, datë 8.2.2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet se autoriteti kontraktor mund të kërkojë certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë.

(Shënim: Autoriteti/enti kontraktor, në varësi të natyrës së objektit të prokurimit, mund të përcaktojë kriterë të tjera të vecanta, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës, duke argumentuar teknikisht dhe ligjërishit çdo kriter, duke përcaktuar, sipas rastit, aktin ligjor/nënligjor që parashikon domosdoshmërinë e kriterit në fjalë).

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

LOTI 2 VESHJE NËNTOKËSORE VARRI

SPECIFIKIME TEKNIKE

1. Një komplet veshje nëntokësore për të rritur përbëhet nga:

- 4 cope pllaka (anësore) me permasa 42x103x4cm dhe zgare hekuri Ø6mm;
- 4 cope pllaka (kapak) me permasa 52x80x4cm dhe zgare hekuri Ø6mm;
- 2 cope pllaka (ballore dhe fundore) me permasa 42x80x4cm dhe zgare hekuri Ø6mm;

Betoni i përdorur të jetë M-200 ose C16/20 dhe zgarë hekuri Ø6mm. Armatura e hekurit është çelik S-500 dhe $400\text{N/mm}^2 \leq F_{yk} \leq 600\text{N/mm}^2$ (rezistenca në rrjedhje), e parashikuar në projekt. Armimi jepet në projektin bashkëlidhur. Elementët duhet të kalojnë periudhën e stazhionimit dhe të shoqërohen me fletë analiza (raporte për betonin dhe hekurin) në kohën e furnizimit.

2. Një komplet veshje nëntokësore për të mitur përbëhet nga:

- 2 cope pllaka (anësore) me permasa 30x105x4cm dhe zgare hekuri Ø6mm;
- 2 cope pllaka (ballore dhe fundore) me permasa 30x50x4 dhe zgare hekuri Ø6mm;
- 2 cope pllaka (kapak) me permasa 50x55x4cm dhe zgare hekuri Ø6mm;

Betoni i përdorur të jetë M-200 ose C16/20 dhe zgarë hekuri Ø6mm. Armatura e hekurit është çelik S-500 dhe $400\text{N/mm}^2 \leq F_{yk} \leq 600\text{N/mm}^2$ (rezistenca në rrjedhje), e parashikuar në projekt. Armimi jepet në projektin bashkëlidhur. Elementët duhet të kalojnë periudhën e stazhionimit dhe të shoqërohen me fletë analiza (raporte për betonin dhe hekurin) në kohën e furnizimit.

Skicimet për veshje nëntokësore varri do të jenë bashkëlidhur DST

Argumentimi i specifikimeve teknike: Specifikimet teknike, grafiku i lëvrimit për mallrat objekt prokurimi të secilit lot, janë hartuar nga specialisti i fushës, anëtar i njësisë së prokurimit, të cilat janë bashkëlidhur me dokumentet e tenderit. Ato përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, i ndryshuar me Ligjit nr. 16/2024, datë 8.2.2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të

nenit 36, të LPP, i ndryshuar me Ligjit nr. 16/2024, datë 8.2.2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Grafiku i lëvrimit hartuar nga specailisti i fushës dhe është si më poshtë vijon:

LOTI 2: BLERJE VESHJE NËNTOKËSORE VARRI

Artikulli i	Përshkrimi	Njësia	Sasia	Destinacion i I dorëzimit	Periudha e dorëzimit
1	Veshje varri për të rritur	Komplete	3600	Varrezat Sharrë, Tufinë Magazinë	Sipas grafikut të lëvrimit
2	Veshje varri për të mitur	Komplete	100	Varrezat Sharrë, Tufinë Magazinë	Sipas grafikut të lëvrimit

Sasia e mallit që kërkohet:

Grafiku i lëvrimit të mallit

Nr.	Përshkrimi i mallit	Njësia	Sasia	Muajt							
				Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
1	Veshje varri per te rritur	Komplete	3600	400	400	400	400	500	500	500	500
2	Veshje varri per te mitur	Komplete	100	10	10	10	10	10	10	10	30

Afatet e lëvrimit: Afati i lëvrimit fillon nga data e nënshkrimit të kontratës dhe përfundon më 31.12.2025

Argumentimi i grafikut: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenet 15, ika 3/b si dhe nenit 40, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Grafiku i lëvrimit për mallrat objekt prokurimi është hartuar nga specialisti i fushës, anëtar i njësive të prokurimit. Grafiku është bashkëlidhur dokumentave të tenderit dhe

është hartuar në përputhje me nevojat e sektorëve. Në muajt e fundit të vitit kërkohen më shumë, në mënyrë që të krijohet rezerva për muajt e parë të vitit pasardhës.

Shënim: *Operatorët ekonomikë ofertues në më shumë se një Lot, duhet të kenë kapacitetet teknike (nënpika 1 pikës 2.2, të kriterëve të veçanta për kualifikim), sa shuma e loteve për të cilat ka ofertuar, të marra së bashku. Në rast se dokumentacioni i deklaruar dhe i dorëzuar në përmbushje të kriterëve kumulative nuk plotëson kapacitetet ekonomike - financiare dhe kapacitetet teknike për të gjitha Lotet ku operatori ekonomik ka ofertuar, do të skualifikohet nga të gjitha Lotet ku ka ofertuar.*

Shënim: *Në mbështetje të nenit 88 pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, nëse kemi bashkim operatorësh ekonomikë, secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, i ndryshuar me Ligjit nr. 16/2024, datë 8.2.2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.*

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

NJËSIA E PROKURIMIT